



Datë: 19.05.2025
Numër Protokolli: 3253/2025

A.nr.505/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtare, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.368/2025 të datës 25.02.2025, të parashtruar nga ankuesja N.S dhe ankesës me numër A.nr.505/2025 të datës 19.03.2025, të parashtruar nga ankuesi A.D, kundër organit të punësimit: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Inspektorati Qendrorë i Punës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.505/2025, e datës 19.03.2025, e parashtruar nga ankuesja N.S dhe ankuesi A.D.

II. Anulohet në tersi procedura e rekrutimit e shpallur sipas konkursit me Nr. Reference: RN00016054, për pozitën e punës “*Drejtor Ekzekutiv*” i Inspektoratit Qendrorë të Punës, dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë.

III. Obligohet Ministri i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, për zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimin të tij, ashtu sikurse është përcaktuar në piken II të dispozitivit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesit, N.S dhe A.D (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesit), më datë 25.02.2025, respektivisht më datë 19.03.2024, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016054, për pozitën e punës së Kategorisë së Lartë Drejtuese “Drejtor Ekzekutiv”, i Inspektoratit Qendrorë të Punës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 2574/2025, të datës 17.04.2025, ka bërë bashkimin e ankesës me numër A.nr.368/2025 të datës 25.02.2025, të parashtruar nga ankuesja N.S dhe ankesës me numër A.nr.505/2025 të datës 19.03.2025, të parashtruar nga ankuesi A.D, ashtu që ankesat kanë marrë numrin e fundit A.nr.505/2025.

Ndërsa, Kryetari I Këshillit pas pranimit të kërkesës së Kryetarit të Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, përmes Vendimit VK/2025 dhe numër protokolli 2897/2025, të datës 30.04.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.505/2025 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1218/2025 të datës 25.02.2025, të parashtruar nga ankuesja N.S, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 14.10.2024, të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Barazi Gjinore; Njoftimin me numër protokolli 01.03-6534 të datës 15.11.2024, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Statistikave të Kosovës; Njoftimin e datës 30.03.2023, të Agjencisë për Informim dhe Privatësi; Njoftimin e datës 07.03.2023, të Agjencisë për Informim dhe Privatësi; Njoftimin e datës 18.10.2023, të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor; Njoftimin e datës 13.06.2024, të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor; Njoftimin me numër protokolli 251-03/1 të datës 26.08.2024, të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas; Njoftimin me numër protokolli 7287 të datës 16.09.2024, të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë; Njoftimin me numër protokolli 2645 të datës 22.08.2024, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Kosovës, për Produkte Medicinale; Njoftimin e datës 19.06.2024, të Menaxherit të Personelit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë; Njoftimin me numër protokolli 3899 të datës 20.09.2024, të Sektorit të Burimeve Njerëzore të Agjencinë Pyjore të Kosovës; Njoftimin e datës 22.10.2024, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale; Konkursin me numër reference RN00016054, të datës 16.12.2024; Formularin e vlerësimit të rezultateve të punës të datës 21.02.2025; Njoftimin e datës 30.01.2025, të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve; Listën përfundimtare të vlerësimit të kandidatëve të datës 20.02.2025, të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve; Njoftimin e datës 20.02.2025, të Divizionit të Burimeve Njerëzore

në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve; Dokument identifikimin e ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 03.04.2025; Kërkesën e datës 30.10.2024; Ankesën me numër protokoli 1827/2025 të datës 19.03.2025, të parashtruar nga ankuesi A.D, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dokument identifikimi i ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 04.04.2025; Rënditja përfundimtare e kandidatëve, e datës 19.02.2025; Pyetjet e intervistës; E-mailin e datës 31.01.2025; E-mailin e datës 26.12.2024; E-mailin e datës 20.02.2025; Njoftimin e datës 07.02.2025, për testin me shkrim; Ftesat e datës 13.02.2024, për intervistën me gojë; Vendimin Nr.19/247 të datës 31.01.2024, për themelimin e Komisionit Ad-Hoc, të Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Vendimin Nr.13/151 të datës 17.07.2023; Vendimin me Nr.18/112 të datës 13.12.2022; Vendimin me numër protokoli 1520 të datës 12.04.2024; E-mailin e datës 04.04.2024; Vendimin Nr.08/130 të datës 22.03.2023; Vendimin me Nr.246/2024 të datës 05.08.2024; Aplikacionin e datës 03.01.2025, të kandidatit L.A, së bashku me shkresat e bashkangjitura për konkursin përkatës; Aplikacionin e datës 14.01.2025, të kandidatit H.N, së bashku me shkresat e bashkangjitura për konkursin përkatës; Aplikacionin e datës 24.12.2024, të kandidatit G.H, së bashku me shkresat e bashkangjitura për konkursin përkatës; Aplikacionin e datës 30.12.2024, të kandidatit I.M, së bashku me shkresat e bashkangjitura për konkursin përkatës; Aplikacionin e datës 30.12.2024, të kandidatit N.S, së bashku me shkresat e bashkangjitura për konkursin përkatës; Aplikacionin e datës 15.01.2025, të kandidatit V.L, së bashku me shkresat e bashkangjitura për konkursin përkatës; Aplikacionin e datës 27.12.2024, të kandidatit V.M, së bashku me shkresat e bashkangjitura për konkursin përkatës; Aplikacionin e datës 24.12.2024, të kandidatit B.Gj, së bashku me shkresat e bashkangjitura për konkursin përkatës; Aplikacionin e datës 18.12.2024, të kandidatit B.Gj, së bashku me shkresat e bashkangjitura për konkursin përkatës; Testet me shkrim dhe Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesve, **është e bazuar, sepse:**

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i provave të lëndës, ka gjetur se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me datë 16.12.2024, ka shpallur konkursin me numër reference RN00016054, për pozitën e punës të Kategorisë së Lartë Drejtuese “*Drejtor Ekzekutiv*”, i Inspektoratit Qendrorë të Punës, me afat aplikimi nga data 17.12.2024 deri më datë 15.01.2025, ku sipas sipas pikës 3 të këtij konkursi, kërkesa të përgjithshme formale, kanë qenë këto:

- **a) Arsimimi i kërkuar:** Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor), e pa specifikuar.
- **b) Kërkesa specifike:** Nuk ka.
- **c) Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku tetë (8) vite përvojë pune profesionale duke përfshirë njëren nga kërkesat në vijim:

c.1.) pesë (5) vite përvojë pune në pozita drejtuese, ose

c.2.) katër (4) vite përvojë punë në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të dytë të arsimit të lartë (master), ose

c.3.) tre (3) vite përvojë punë në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të tretë të arsimit të lartë (doktoratës).

Nga shkresat e lëndës, rezulton se në këtë konkurs fazën e verifikimit paraprak, si kandidatë që kanë plotësuar kriteret e konkursit, e kanë kaluar njëmbëdhjetë (11) kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesit, të cilët kanë marrë pjesë në të gjitha fazat e vlerësimit të kandidatëve, dhe sipas Listës përfundimtare të vlerësimit të kandidatëve të datës 20.02.2025, rezulton se ankuesi A.D ka arritur 55.6 pikë, ndërsa ankuesja, N.S, ka arritur gjithsejtë 44 pikë të përgjithshme nga kjo procedurë e rekrutimit.

Ndërsa, sipas Njoftimit të datës 20.02.2025, të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, rezulton se kandidati H.N, me gjithsejtë 83.6 pikë të arritura dhe kandidati L.A, me gjithsejtë 75.8 pikë të arritura, nga kjo procedurë rekrutimi, janë shpallur kandidatë si kandidat fitues për pozitën e Kategorisë së Lartë Drejtuese “*Drejtor Ekzekutiv*”, i Inspektoratit Qendrorë të Punës.

Ankuesit, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e kundërshtojnë në tersi procedurën e rekrutimit të lartë cekur, duke theksuar se e njëjta është zhvilluar përmes shkeljeve procedurale, shkeljeve ligjore dhe mos krijimit të kushteve të barabarta të kandidatëve, duke theksuar ndër të tjera se shpallja dhe zhvillimi i kësaj procedure rekrutimit nga ana e NJMBNJ e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, për pozitën e Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendrorë të Punës, përmes SIMBNJ të Inspektoratit Qendrorë të Punës, është në kundërshtim me nenin 98 paragrafin 2 të Ligjit Nr.08/197 për Zyrtarët Publik, nenin 4 paragrafin 2 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe me nenin 7 dhe 47, paragrafin 1 të Ligjit Nr.08/197 për Zyrtarët Publik, sepse njëri nga kandidatët fitues nuk i plotëson kriteret e konkursit, ashtu të njëjtit kërkojnë anulimin e konkursit përkatës.

Kolegji i Këshillit, në përmbushje të mandatit kushtetues dhe ligjor për sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, si dhe në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, i'u referua, Nenit 16, paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, i cili përcakton se: *1. Çdo institucion që punëson zyrtarë/e publik në fushën e veprimit të këtij ligji, duhet të ketë Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive*”, Nenit 47 paragrafi 2, i cili përcakton se: *“Procedura e rekrutimit organizohet nga ministria përgjegjëse për administratën publike për institucionet e administratës shtetërore dhe nga njësia përgjegjëse, për çdo institucion tjetër shtetëror”*, ndërlidhur me dispozitat kalimtare nga Neni 98 paragrafi 1 dhe 2 i të njëjtit ligj, ku përcaktohet se: *1. Pavarësisht dispozitave të këtij ligji, procedura e centralizuar e rekrutimit për shërbyeset/it civil që zhvillohet nga njësia përgjegjëse në kuadër të ministrisë përgjegjëse për administratë publike, do të fillojë të zbatohet tetëmbëdhjetë (18) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. 2. Deri në periudhën sipas paragrafit 1. të këtij neni, NjMBNj e institucionit përkatës do të zhvillojë procedurën e rekrutimit.*; ndërlidhur me Nenin 1 të Ligjit Nr.06/L119 për Organizmin dhe Funksionimin

e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, ku theksohet se: 1. Ky ligj përcakton rregullat për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura të themeluara nga Kuvendi i Kosovës. 2. Qëllimi i këtij ligji është të krijojë një kuadër ligjor për themelimin, organizimin, funksionimin, përgjegjshmërinë dhe performancën e institucioneve të administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura.; Nenit 9, ku përcaktohet se: 1. Administrata shtetërore përbëhet nga Zyra e Kryeministrit, sistemet ministrore dhe agjencitë rregullatore. 2. Sistemi ministror përbëhet nga: 2.1. ministria; 2.2. agjencia ekzekutive, dhe 2.3. administrata e shërbimeve publike.; si dhe Nenit 26, i cili përcakton se: 1. Agjencia Ekzekutive dhe ajo Rregullatore organizohet si një apo disa departamente në bazë të fushëveprimtarisë. Niveli i organizimit përcaktohet në pajtim me këtë ligj. 3. Shërbimet e përgjithshme të menaxhimit, menaxhimit financiar, menaxhimit të burimeve njerëzore dhe të auditimit të brendshëm në agjencitë ekzekutive, me një numër punonjësish më të vogël se pesëdhjetë (50), kryhen nga njësia përgjegjëse administrative e ministrisë përgjegjëse. 4. Në rastin e agjencive ekzekutive të mëdha dhe me veprimtari komplekse, si dhe agjencive rregullatore, njësitë administrative që kryejnë shërbimet e përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, krijohen brenda agjencisë dhe i raportojnë drejtpërdrejt drejtorit apo organit drejtues kolegjal të agjencisë rregullatore. Rrjedhimisht, referuar këtyre dispozitave ligjore dhe shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit, konstaton se pretendimet ankimore të ankuesve janë të bazuara, ngase Neni 105 të Ligjit Nr.08L-197 për Zyrat e Publikë, ka përcaktuar se: Ky ligj hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.; dhe se duke u bazuar në datën e publikimit 18.09.2023 të këtij ligji, rezulton se i njëjti ka hyrë në fuqi më datë 25.09.2023, ndërsa shpallja e konkursit përkatës është e datës 16.12.2024, apo thënë më konkretisht para kalimit të periudhës kohore prej 18 muajsh që nga hyrja në fuqi e këtij ligji, dhe në këtë kuptim të dispozitave të lartë theksuara ligjore dhe duke pasur parasysh se Inspektorati Qendrorë i Punës, është Agjenci Ekzekutive me një numër më të madh se pesëdhjetë (50) punonjës, që brenda saj ka të krijuar Njësine për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, si rrjedhojë, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, shpalljen e konkursit numër reference RN00016054, për pozitën e punës të Kategorisë së Lartë Drejtuese Drejtor Ekzekutiv në Inspektoratin Qendrorë të Punës, duhej ta shpallte njësia e sapo theksuar, ndërsa nga shkresat e lëndës konstatohet fakti i pa kontestueshëm se në rastin konkret, shpalljen dhe zhvillimin e procedurës përkatëse të rekrutimit e ka realizuar Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Tutje, Kolegji i Këshillit, referuar nenit 48, të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrat e Publik, ku përcaktohet se: 1. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për emërimin në pozitë të kategorisë së lartë drejtuese në administratën shtetërore bëhet nga komisioni shtetëror i pranimit. 2. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për emërimin në pozitë të kategorisë së lartë drejtuese në një institucion tjetër shtetëror, bëhet nga komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së lartë drejtuese që themelohet në çdo institucion tjetër shtetëror. 3. Komisioni shtetëror i pranimit për pozita të kategorisë së lartë drejtuese në administratën shtetërore, apo komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së lartë drejtuese që themelohet në çdo institucion tjetër shtetëror ka pesë (5) anëtare/ë, në këtë përbërje: 3.1. tre (3) nëpunës/ës ekzistues në pozitë të kategorisë së lartë drejtuese; 3.2. udhëheqësen/in e njësisë përgjegjëse; 3.3. një (1) eksperte/t i jashtëm.; dhe Nenit 23, të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: 1. Komisioni i pranimit për vlerësimin profesional të kandidatëve për emërimin në pozitë të kategorisë së lartë drejtuese themelohet me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës për institucionet e administratës shtetërore. Komisioni i pranimit në

*institucionin tjetër themelohet me vendim të titullarit të institucionit. 2. Komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së lartë drejtuese ka pesë (5) anëtarë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës ekzistues në pozitë të kategorisë së lartë drejtuese; 2.2. **udhëheqësin e NJMBNJ-së të institucionit që zhvillon procedurën**; 2.3. një (1) ekspert i jashtëm.; si dhe duke u bazuar në konstatimin e më sipërm se pavarësisht asaj që organi përkatës në të cilin është zhvilluar procedura e rekrutimit për plotësimin e pozitës së lirë, e ka të themeluar NJMBNJ e vet përkatëse, mirëpo duke qenë se përmes SIMBNJ të Inspektoratit të Qendrorë të Punës, është shpallur konkursi me numër reference RN00016054, për pozitën e punës të Kategorisë së Lartë Drejtuese *Drejtor Ekzekutiv* në Inspektoratin Qendrorë të Punës, ndaj si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit, konstaton se përbërja e Komisionit Ad-hoc për Vlerësimin Profesional të Kandidatëve për Pranim për Pozitën e Kategorisë së Lartë Drejtuese, të emëruar sipas Vendimin Nr.19/247 të datës 31.01.2025. të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është në kundërshtim me këto dispozita ligjore, ngase në përbërje të këtij Komisioni nuk është emëruar udhëheqësi/ja e njësisë përgjegjëse të institucionit për të cilën zhvillohet procedura e rekrutimit apo thënë më konkretisht të Inspektoratit Qendrorë të Punës, por është emëruar anëtare U.D Udhëheqësja e NJMBNJ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Ndërsa po ashtu nga shkresat e lëndës rezulton, se përmes kërkesës së datës 20.02.2025, U.D Udhëheqësja e NJMBNJ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka kërkuar nga DMZP, qasjen në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Inspektoratit Qendrorë të Punës, për përfundimin e kësaj procedure rekrutimi, duke vepruar kështu në kundërshtim edhe me nenin 4 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: 2. *Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj.**

Ndërsa, referuar dispozitave të Nenit, 13 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: 1. *Ministria përgjegjëse për administratë publike ka këto përgjegjësi: 1.1. propozon dhe monitoron zbatimin e politikave për paga për zyrtarët/ët publik dhe funksionarët/ët publik; 1.2. mbështet dhe këshillon institucionet në zbatimin e këtij ligji; 1.3. organizon sipas planifikimit procedurat e pranimit për institucionet e administratës shtetërore në pajtim me këtë ligj; 1.4. planifikon, vendos dhe kryen sistemin e nëpunësve/ëve civil, të cilat/ët kanë përfunduar mandatin, në pajtim me këtë ligj; 1.5. miraton dhe monitoron zbatimin e programeve të trajnimit për nëpunëset/it civil; 1.6. administron dhe mirëmban Sistemin e Informatave për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; 1.7. harton dhe miraton udhëzime të përgjithshme dhe manuale për të garantuar zbatimin e unifikuar të legjislacionit për zyrtarët/ët publik; 1.8. harton politikat e angazhimit të praktikanteve/ëve në administratën publike; 1.9. harton planin e përgjithshëm të personelit; 1.10. përgatit dhe publikon raportin vjetor për menaxhimin e burimeve njerëzore.*, si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit, thekson se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, përmes Kërkesës për sqarime të datës 08.08.2024, ofruar Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, duke theksuar se me rastin e inicimin të procedurës së rekrutimit në DMZP, Ministri mund të kërkojë që procedura e rekrutimit për nivelin lartë drejtues të zhvillohet nga NJMBNJ e Ministrisë amë, nuk ka ofruar rekomandim në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, ngase duke marrë për bazë dispozitat ligjore të Ligjit Nr.06/L119 për Organizmin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, i cili përcakton rregullat për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura të themeluara nga Kuvendi i Kosovës, ku sipas nenit 26 paragrafit 3 dhe 4, qartësisht përcaktohet se : 3. ***Shërbimet e përgjithshme të menaxhimit , menaxhimit financiar, menaxhimit të burimeve njerëzore dhe të auditimit të***

brendshëm në agjencitë ekzekutive, me një numër punonjësish më të vogël se pesëdhjetë (50), kryhen nga njësia përgjegjëse administrative e ministrisë përgjegjëse. 4. Në rastin e agjencive ekzekutive të mëdha dhe me veprimtari komplekse, si dhe agjencive rregullatore, njësitë administrative që kryejnë shërbimet e përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, krijohen brenda agjencisë dhe i raportojnë drejtpërdrejt drejtorit apo organit drejtues kolegjal të agjencisë rregullatore.; që nënkuptohet se Agjencitë Ekzekutive, që kanë më shumë se 50 punonjës i kanë të krijuara NJMBNJ e tyre, dhe se në kuptim të kompetencave të përcaktuara nga paragrafi 2 i nenit 17, të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, procedurat e rekrutimit për të gjitha kategoritë e nëpunësve civil, mund ti zhvillojnë të njëjtat pa pasur nevojë që procedurat të zhvillohet nga NJMBNJ e Ministrisë amë, veprime që duheshin ndërmarrë sikurse në rastin konkret, me rastin e shpalljes dhe zhvillimit të procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016054, andaj në vlerësim e Kolegjit të Këshillit, ky opinion nuk është në pajtim me dispozitat e theksuara ligjore dhe me qëllim të zbatimit të ligjshmërisë duhet njoftuar institucionet përkatëse lidhur me mos aplikimin e këtyre veprimeve të rekomanduara.

Andaj, bazuar në rrethanat dhe konstatimet e dhëna si në arsyetim të këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstaton se shpallja e konkursit përkatës nga organi jo kompetent, emërimi i Komisionit Ad-hoc, rrjedhimisht mungesa e autorizimeve ligjore për përdorimin SIMBNJ të Inspektoratit Qendrorë të Punës, ka bërë që procedura e rekrutimit, që nga shpallja e deri tek njoftimi përfundimtar i datës 20.02.2025. të zhvillohet në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Ligjit Nr.06/L119 për Organizmin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, Rregullores Nr.05/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.15/2023, dhe se për shkak të shkeljeve të evidentuara si më lartë kjo procedurë e rekrutimit konsiderohet e paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit me qëllim të kthimit të ligjshmërisë vendosi për aprovimin e ankesës si të bazuar, dhe anulimin e procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016054, për pozitën e punës “*Drejtor Ekzekutiv*”, i Inspektoratit Qendrorë të Punës, sikurse është përcaktuar në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.505/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses, N.S dhe ankuesit, A.D;
- Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqëses të Divizionit të Burimeve Njerëzore, të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- DMZP-së;
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin Qëndror të Punës; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.